



MBËSHTETJE REFORMËS NË SHËNDETËSI



"Me asistencën teknike që kemi pasur nga USAID-i, filluam menjëherë punën në një grup pune për hartimin e planit të punës me qëllim krijimin e Shërbimit të Kujdesit Mjedisor."

Shërbimi për mirëmbajtjen e pastërtisë dhe të higjienës së mjedisit spitalor

22

DREJTORI NONAJ

Sfidat e mia me maternitetin. Ja masat që morëm 23



INFEKSIONET SPITALORE

Bashkëpunim intensiv për uljen e tyre 26

NISMA E USAID-IT

Pacienti në qendër të sistemit shëndetësor 24,25



PANELI LEZHË

Urë komunikimi mes qytetarit dhe mjekëve 25



Shërbimi për mirëmbajtjen e pastërtisë dhe të higjienës së mjedisit spitalor

Shërbimi i Kujdesit Mjedisor vjen për herë të parë në sistemin tonë shëndetësor pikërisht në maternitetin "Mbretëresha Geraldinë" falë mbështetjes së Projektit të USAID "Mbështetje Reformës në Shëndetësi". Ky shërbim vjen me një manual përdorimi të hartuar sipas të gjitha standarteve.

Shefja e Shërbimit të Kujdesit Mjedisor, Vera Beça, me profesion mjekë mikrobiologe shpjegon të gjitha hapat që janë ndjekur për krijimin e këtij shërbimi.

Krijimi i sektorit

"Me asistencën teknike që kemi pasur nga USAID-i, filluam menjëherë punën në një grup pune për hartimin e planit të punës me qëllim krijimin e Shërbimit të Kujdesit Mjedisor.

"Filluam me një trajnim në spitalin "Hygeia" për të parë në mënyrë konkrete se si zbatoheshin standardet e këtij shërbimi. Më pas u përkushtuam në hartimin e manualit dhe sfida më e madhe ishte praktika në terren", pohon Beça, duke shtuar se aprovimin e manualit ia paraqitën në radhë të parë drejtor-

Shefja e Shërbimit të Kujdesit Mjedisor, Dr. Vera Beça, me profesion mjekë mikrobiologe shpjegon se si arritën të krijojnë për herë të parë në vendin tonë këtë shërbim sipas të gjitha standarteve



isë dhe pas aprovimit nga drejtorja e spitalit, ia paraqitën edhe Ministrisë së Shëndetësisë me argumentet përkatëse për krijimin e Shërbimit të Kujdesit Mjedisor.

"Dikasteri i Shëndetësisë e miratoi dhe ne filluam menjëherë nga puna, - thotë Beça. - Kjo strukturë e re ka në përbërje shefin e shërbimit dhe 3 supervisorë të cilët i kemi ndarë sipas zonave me risk dhe pikërisht: zona me risk të ulët, të mesëm dhe të lartë. Këto zona kanë nga një supervisor i cili bën veprimet sipas standardeve percaktuara në manual për secilën zonë. P.sh. zona me rrezik të lartë janë parashikuar salla e lindjes, laboratorët e analizave, salla e operacionit. Në këto zona pastrimi duhet të jetë intensiv dhe në çdo detaj".

Detajet e shërbimit

"Punonjësi që merr turnin dhe hyn për të pastuar në një ambjent ka si detyrë të zbatojë procedurat përkatëse të shkruara në manual për çdo detaj, si p.sh.: nëse po pastron një sallë lindje do të ndjekë procedurën përkatëse të pastrimit, e cila nuk është e njëjtë me mënyrën e pastrimit të një dhome



pacienti. Gjithashtu punonjësi i kujdesit mjedisor duhet të raportojë edhe defektet teknike që mund të hasë gjatë punës", tregon Beça duke theksuar bashkëpunimin me degën teknike mbi kujdesin mjedisor. Në këtë shërbim është e rëndësishme edhe etika e veshjes së personelit. Në manual janë përcaktuar të gjitha detajet që kanë të bëjnë me etikën e stafit mjekësor. "Duhet ta dijë i gjithë stafi që punon në një institucion shëndetësor që paraqitja e jashtme është ajo që krijon te pacienti përshtypjen e parë ndaj kujdesit që po i ofrohet. Të gjithë në një ambient të pastër dhe me rregull do të ndiheshim mirë si në rolin e ofruesit të kujdesit shëndetësor dhe në rolin e marrësit të këtij shërbimi", thekson mjekja.

Larja e duarve

Më tej ajo shpjegon se në të gjithë maternitetin bashkë me fletëpalosjen është vendosur edhe një poster mbi lavaman që tregon mënyrën e larjes së duarve dhe se si duhet t'i ketë duart një punonjës në maternitet, si p.sh.: pa unaza me gurë në duar, pa thonj të gjatë, pa aksesorë nëpër duar etj, sepse duart e stafit mjekësor janë ato që komunikojnë me pacientin.

"Mendojmë që të përcjellim tek pacienti më shumë siguri dhe besim në kujdesin shëndetësor që i ofrohet në spitalin tonë.

Detyrat

Një pikë tjetër e rëndësishme në manual është edhe ndarja e detyrave, domethënë ndarja e detyrës së punonjësve të kujdesit mjedisor nga detyrat për të cilat është përgjegjëse mamia dhe infermierja.

Shefja e Kujdesit Mjedisor, Vera Beça, shpjegon se deri tani sanitaria ishte ndihmëse e pacientit për ta shoqëruar me bagazhe apo edhe për ta shoqëruar në tualet etj. "Tashmë e kemi ndarë që Shërbimi i Kujdesit Mjedisor nuk ka si detyrë t'i shërbejë pacientit, por ka si detyrë t'i shërbejë vetëm mjedisit", thotë ajo.

Listë kontrolli

Këto lista janë sipas të gjitha shërbi- meve dhe në këto lista janë të nënshkruara sipas standardeve të gjitha proceset të cilat duhet të ndiqen hap pas hapi me detaje për objektet dhe aksesorët dhe supervizorja që ka turnin, bën kotrollin sipas listës.

Drejtori Nonaj: Masat që morëm për të ulur infeksionet spitalore

"Krijimi për herë të parë i Shërbimit të Kujdesit Mjedisor në maternitetin tonë është mundësuar falë projektit "Mbështetje Reformës në Shëndetësi" mbështetur nga USAID". Kështu u shpreh drejtori i maternitetit "Mbretëresha Geraldinë", Blenard Nonaj, i cili pohon se ngritja e këtij shërbimi do të ulë përqindjen e infeksioneve spitalore. Kemi pasur ndihmë në çdo hap nga projekti duke filluar që nga njohja e stafit me praktikat më të mira, asistencë teknike në hartimin e manualit dhe tani presin që gjithshka të plotësohet me asistencën materiale të paisjeve të cilat do ta çojnë shërbimin e ofruar nga ky shërbim në standartet bashkëkohore.

"Sapo mora detyrën si drejtor, bëmë një matje të ngarkesës mikrobike në maternitet. Duhet të dinim se çfarë lloj infeksionesh kishte në maternitet si për sallën e lindjes, sallën e gjinekologjisë, sallën e operacionit dhe të të gjitha shërbimeve. Rezultatet treguan se kishte një rritje të ngarkesës mikrobike", pohon drejtori Blenard Nonaj duke shtuar se për të përmirësuar situatën u morën disa masa.

"Filloi një pastrim intensiv me detaje, sidomos në disa shërbime të veçanta si salla e operacionit, sallat e lindjes dhe ambjeteve të tjera. U morën disa masa, si për shembull: ndalimi rreptësisht i hyrjes së mjekëve me këpuçë në sallat e operacionit dhe sallat e lindjes etj", thotë Nonaj.

Sipas tij, u vu re një ndryshim nga më parë dhe pasi u bënë matjet e nivelit të ndotjes mikrobiologjike në ambjete, ato ranë deri në 20 përqind. Prioritetet

"Materniteti "Mbretëresha Geraldinë" është një maternitet për të cilin mendoj se gjërat deri më sot kishin funksionuar 50% me 50%. Duhet të theksoj se nuk duhet të shohim vetëm fasadën, por edhe brendësinë e gjërave", thotë drejtori Blenard Nonaj, i cili nuk lë pa përmendur edhe problematikat që mund të ndeshen në institucionin që drejton.

"Ky institucion ka probleme me aparaturat dhe këto janë shumë të rëndësishme, sepse janë mall konsumi. Ka rreth 15 vjet që nuk janë blerë aparatura të reja. Strategjia ime si fillim është të rregullojmë pjesën e aparaturave dhe këtë po përpiqemi ta sigurojmë në disa rrugë. Po bashkëpunojmë edhe me Ministrinë e Shëndetësisë për një shpërndarje më të mirë në mënyrë që një pjesë e aparaturave në disa rrethe të cilat nuk shfrytëzohen, të sillen në maternitetin tonë. Kemi një anë të mirë, sepse nuk kanë munguar

medikamentet dhe besoj se do ta vazhdojmë këtë rrugë", shprehet Nonaj.

Ndërkohë ai thekson se po punojnë për të rritur kapacitetin e kualifikimit të mjekëve.

"Duhet të fillojmë edhe me përmirësimin e kushteve të mjekëve. Nëse bluzat e bardha nuk ndihen mirë në punën e tyre, as shërbimi ndaj pacientëve nuk është cilësor. Në radhë të parë duhet filluar me kushtet e punës së mjekëve, nga ku kemi filluar me dhomat e tyre", thotë drejtori. Ndërkohë shpjegon se po përpiqen të shtojnë edhe dhomat e pacienteve, pasi 83 shtretër janë për pjesën e lindjeve dhe këto nuk janë mjaftueshëm ku brenda 24 orëve mesatarisht ka 20 lindje dhe Tirana po shkon në rreth 1 milion banorë. Ndaj lind nevoja e shtimit të shtretërve dhe po shqyrtohet ndonjë mundësi për këtë.



Bajraktari: Sfidat që ndeshëm në zbatimin e manualit



Procesi i zbatimit të Manualit të Kujdesit Mjedisor ka pasur vështirësi dhe sfida. Aurora Bajraktari, infermiere e Njesisë së Kontrollit të Infeksioneve, shpjegon se kjo nismë nuk ishte e lehtë të zbatohet me përpikmëri që në hapat e parë të saj. "Në fakt, na dolën shumë sfida përpara dhe kjo fillonte që me infrastrukturën e spitalit, por edhe me mentalitetin që ishte krijuar më parë. Ka edhe disa standarde të cilat nuk u arritën, por jemi duke i përmirësuar. Megjithatë më e rëndësishme është që Shërbimi i Kujdesit Mjedisor u krijua si një departament më vetë, si gjithë shërbimet e tjera", thekson Bajraktari duke shtuar se kjo praktikë që po ndjekin, po i ndihmon shumë në reduktimin e infeksioneve spitalore. "Tashmë vihet re ndryshimi dhe ne po përpiqemi për një higjienë gjithnjë e më të mirë në çdo pjesë të spitalit tonë. Është më pak e kushtueshme të parandalosh se të mjekosh".

Mami Saida: Pastrimin e bëjmë sipas protokollit

Veprimet e saj duken të përpikta. Mban në dorë dorezat dhe pastrimin e bën në mënyrë shumë korrekte. Sot mamia Saida Shera ka turnin pikërisht në repartin e obstetrikës. "Sot jam mamia e sallës së lindjes dhe jam në detyrë. Duhet ta përgatisim sallën në çdo detaj me korrektësi dhe pastërti maksimale. Çdo të mërkurë këtu merret material për të parë ndotjen mikrobike të sallës dhe të gjitha veprimet tona janë me protokoll", pohon mamia.

Nëna Eglantina: "Kisha frikë para se të vija, por tani mendoj ndryshe"

Ajo duket shumë e lumtur tek mban foshnjën në gji. Megjithatë, gjen pak minuta që të na japë edhe ne informacion. Eglantina ka lindur fëmijën e dytë në këtë maternitet. "Para se të shtrohesha kisha një mendim tjetër gati në frikë për të ardhur këtu. Tani mund të flas ndryshe. Vë re përkujdesjen nga stafi dhe jam me foshnjën time në një mjedis të pastër. E them sërish se e kisha me frikë të vija, aq sa doja të merrja edhe çarçafët nga shtëpia dhe këtë e kisha nga përvoja, sepse kam edhe një djalë më të madh 4 vjeç dhe kur bëj krahasimin atëherë me tanë, është shumë ndryshe", pohon ajo.



RISI: Paneli Këshillimor Qytetar në Spitalin Rajonal Lezhë

Projekti i USAID "Mbështetje Reformës në Shëndetësi" (MRSH) ofron asistencë teknike për Spitalin Rajonal Lezhë për ngritjen e urave të bashkëpunimit dhe komunikimit për ta bërë zërin e qytetarëve pjesë të vendimmarrjes që lidhen me shërbimin shëndetësor në këtë Spital.

Për të siguruar pjesëmarrje sa më të gjerë të të gjithë aktorëve në këtë proces, MRSH do të punojë për të rritur angazhimin e shoqërisë civile dhe për forcimin e ndërveprimit mes Spitalit Rajonal Lezhë, shoqërisë civile dhe qytetarëve duke krijuar dhe institucionalizuar Panelin Këshillimor Qytetar. Ky parakusht u përfshi në Vendimin me NR. 308 Prot. Nr. 3, që u nënshkrua nga secili anëtar i Panelit Këshillimor Qytetar dhe pjesëmarrës i Spitalit Rajonal Lezhë me datë 17.09.2013.

Paneli Këshillimor Qytetar Lezhë është një grupim vullnetar dhe synon të shërbejë si njësi këshillimore për Spitalin rajonal Lezhë. Ky panel do të jetë gjithëpërfshirës, një angazhim dypalësh me Spitalin Rajonal Lezhë, ai ka përfaqësim të gjerë (madje edhe gjeografike, brenda rajonit Lezhë) me qytetarë që kanë vizion dhe duan të

mundësojnë ndryshime pozitive në rajonin/qytetin e tyre. Paneli Këshillimor Qytetar Lezhë ka 12 anëtarë 5 janë përfaqësues të Spitalit Rajonal Lezhë dhe 7 përfaqësues të komunitetit (drejtues dhe përfaqësues të OJQ-ve vendore, bizneseve, rinisë, grave dhe grupeve të marginalizuara). Pjesëmarrja e gjerë ka si synim të bëjë të mundur trajtimin e sa më shumë tematikave dhe problemeve me rëndësi për komunitetin që gjithsecili prej tyre përfaqëson. Në diskutimet e Panelit Këshillimor Qytetar marrin pjesë edhe punonjës nga Spitali Rajonal Lezhë. Ky panel do të mbledhet rregullisht për çështje që lidhen me ofrimin dhe cilësinë e shërbimeve, si dhe me përparësitë e SRL.

Projekti MRSH do t'ju krijojë mundësi anëtarëve të panelit për njohjen e nismave të iniciuara nga projekti MRSH, por jo vetëm progresin në zbatim të këtyre iniciativave në SRL, ngritjen e kapaciteteve në tematika që kanë të bëjnë me mbrojtjen e interesave të qytetarëve etj. MRSH do t'i njohë ata me praktikatat novatore në angazhimin qytetar, si dhe mbrojtjen me efektivitet të interesave të tyre.

Paneli këshillimor qytetar zhvilloi takimin e radhës në qytetin e Lezhës në një komunikim shoqëri civile – mjekë. Pritet që puna e tij të krijojë ura lidhëse mes qytetarëve dhe spitalit

Nisma e USAID-it: Pacienti në qendër të sistemit shëndetësor

Arlinda Gjypi

Në qytetin e Lezhës u zhvillua takimi i radhës me përfaqësues të projektit të USAID "Mbështetje Reformës në Shëndetësi", përfaqësues të shoqërisë civile e organizatave të ndryshme, si dhe përfaqësues të spitalit Rajonal të Lezhës. Një panel i tillë synon të vendosë zërin e qytetarit në pozicion qendror sa i përket përmirësimit të vendimmarrjes, e cila duhet të jetë pasqyrim i nevojave dhe perspektivës së pacientëve, rritjen e cilësisë së shërbimit, duke e vënë në këtë mënyrë pacientin në qendër të sistemit shëndetësor.

Në hapje të takimit drejtori i spitalit të Lezhës, Dr. Nevruz Bara, informoi të pranishmit mbi nismat e projektit të USAID-it "Mbështetje Reformës në Shëndetësi" të aplikuar në këtë spital, si dhe efektet e secilës nismë në rritjen e kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimit.

"Ishte një periudhë kur stafi nuk njihej me njëritjetrin dhe nuk kishin dijeni lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre. Kemi pasur dhe raste të veçanta ku infermierja nuk njihje drejtorin, për shembull, dhe kjo sillte pastaj edhe probleme në zbatimin e detyrave përkatëse", u shpreh Dr. Bara. Ai informoi dhe lidhur me iniciativën e mirëmanaxhimit të vizitorëve, hyrje-daljet e pakontrolluara, të cilat kanë qenë një problem vërtet i madh për një kohë të gjatë dhe për këtë "kemi një vit që kemi filluar t'i manaxhojmë. Me mbështetjen e projektit ne kemi hartuar manualin e mirëmanaxhimit të vizitorëve, gjë e cila ndikon në rritjen e cilësisë së shërbimit, por njëkohësisht edhe në uljen e infeksioneve spitalore. Tashmë ka një rregullore e cila parashikon oraret e hyrje-daljeve, si dhe kohëqëndrimi në dhomën e të sëmurit". Sipas Dr. Barës, ka edhe raste kur pacientët nuk duan që të kenë vizitorë. Në këtë rast, personeli respekton vendimin e tij/saj e nuk lejon që ai të shqetësohet.

Një tjetër iniciativë që vlen vëmendjen ishte mosraportimi i incidenteve. Ka mbi një vit tashmë që po zbatohet një praktikë e tillë e raportimit të incidenteve, e cila na ndihmon në realizimin me sukses të detyrave tona të përditshme.

Ndërkohë, Dr. Tonin Rumia, koordinatori i spitalit për projektin u shpreh se ardhja orar-pa orar e vizitorëve sillte probleme edhe në shërbimin ndaj pacientit. "Në çfarëdo orari tek i sëmurit kishte 3-4 familjarë që rrinin, dëgjonin, vështronin e sugjeronin ç'po bënin mjeku apo infermierja. Të dy këta të fundit ishin nën vëzhgimin e gjithë fisit. Tashmë që janë rralluar vizitat dhe janë me orar, mjeku është më i qetë. Po ashtu edhe infermierja është më e qetë dhe punon më mirë ndërsa i shërben pacientit. Për më tepër tashmë edhe nuk pengohet, ndërsa bën detyrën e saj".

Sipas Dr. Rumias, për të rregulluar situatën me vizitorët e shumë një përgjegjësi e madhe i është dhënë edhe mjekut kurues. Ky i fundit komunikon me familjarët dhe u shpjegon atyre rëndësinë e uljes së numrit të vizitave në mënyrë që i afërmi i tyre të jetë sa më pak i ekspozuar ndaj infeksioneve. Duke informuar edhe njerëzit bëhen më bashkëpunues.

"Farmacia ka qenë një tjetër problem yni, - tha drejtori i spitalit në fjalën e tij. - Si rrjedhojë u pa nevoja për një pozicionim të ri të saj konform standardeve bashkëkohore të cilën pritet që ta përurojmë së shpejti.

"Gjatë kësaj periudhe sigurisht ka pasur pakënaqësi për probleme të ndryshme si ushqimi apo çarçafët. Ndaj e menduam si të drejtë që të bënim një ndërhyrje te kuzhina dhe lavanteria. Zgjidhja më e mirë ishte nënkontraktimi i një firme që do të merrej me këto çështje. Tashmë kemi nënkontraktuar lavanterinë gjithmonë me synimin e e përmbushjeve të nevojave të pacientëve ndaj këtij shërbimi dhe punojmë në vijimësi për mbikëqyrjen dhe zbatimin e standardeve të kërkuara".

Mësohet gjithashtu se ndërkohë po negociohet për nënkontraktimin e një firme për kuzhinën, në mënyrë që të bëhet shpërndarja e ushqimit edhe në bazë të llojit të sëmundjes që ka pacienti, pasi deri më tani një gjë e tillë nuk është bërë.

"Ndërkohë kemi krijuar Departamentin e Shërbimeve Mjedisore. Krijimi i tij ka ndikuar në ndryshimin e rrënjësishëm të situatës, pasi është bërë një shpërndarje më e mirë e burimeve dhe janë ulur infeksionet spitalore".





Dorina Ndreca

Anëtare e Panelit Këshillues

"Do të ngre zërin për të ndihmuar invalidët"

Jam pjesë e komunitetit të Lezhës, kam lindur dhe jam rritur këtu. Mendoj se ky panel është risi në qytetin tonë dhe jam e sigurtë se do të ecë shumë mirë. Vërtet ndihemi të vlerësuar që tashmë institucionet kanë filluar që të bëjnë pjesë të vendimmarrjes edhe vetë qytetarët. Mendimet e mia për problemet që shqetësojnë komunitetin do filloj t'i hedh në tryezë në mënyrë që të fillojnë të merren në konsideratë. Për të parët që do të ngre zërin, do të jenë personat me aftësi të kufizuara, sepse ata duhet të kenë më shumë akses në shërbimet shëndetësore dhe të ndihen më të përfaqësuar. Mendoj se deri më sot nuk janë parë prioritet, por tashmë ka ardhur koha që këta njerëz në nevojë të ndihmohen. Këtë e them jo vetëm se kam babin invalid dhe ka nevojë për ndihmë, por këtë kategori nuk e kam parë të përfaqësuar askund.



Paneli, urë komunikimi mes qytetarit dhe spitalit

Ndërkohë, përfaqësuesja e projektit të USAID-it "Mbështetje Reformës në Shëndetësi" u shpreh:

"Ky projekt është prezantuar fillimisht si ide përpara aktorëve kryesorë të shëndetësisë si përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë, urdhrat e mjekut, farmacistit, infermierit, OJF të ndryshme, shoqata pacientësh etj. Ideja e tij është vendosja e pacientit në qendër të sistemit shëndetësor. Pasi pacienti duhet të jetë pjesë e vendimmarrjes.

"Risja është se kjo nismë po pilotohet për herë të parë në Shqipëri në Spitalin Rajonal Lezhë dhe duke pasur parasysh gatishmërinë dhe angazhimin e shprehur nga drejtuesit e stafi i spitalit drejt transparencës dhe shndër-

rimeve pozitive kemi besim se një nismë e tillë do të ecë mirë".

Qëllimi i panelit këshillimor është pikërisht të vendosë një urë komunikimi mes qytetarit dhe spitalit. Në një bashkëpunim të parë me spitalin vendosëm se cilët do të ishin përfaqësuesit e qytetarëve dhe pikërisht ata që do të ishim më përfaqësuesit për zërin e tyre. Paneli ka 12 anëtarë, pesë prej të cilëve do të jenë përfaqësues të spitalit, dhe 7 përfaqësues të komunitetit të rajonit Lezhë.

Anëtarët e panelit zgjidhen një herë në tre vjet, por gjithsesi anëtarët nuk do të ndryshohen të gjithë njëherësh, por me rotacion. Ky panel ka edhe strukturat e veta drejtuese: kryetar, nënkryetar dhe sekretariat.



Ta bësh të prekshme mjekësinë është vërtet diçka shumë e mirë, sidomos për shkak të paragjytimeve që ekzistojnë. Ky panel është një vend për të sjellë zërin tonë

Paneli, informim i ndërsjelltë mjekë-qytetar

Pyetjes së gazetarëve të pranishëm në takim se si është përzgjedhur paneli, Mirela Cami, përfaqësuese e projektit iu përgjigj se që kur projekti ishte në fillesat e tij dhe ende pa u përzgjedhur Lezha si qytet, ku ky panel do të aplikohet u bë një studim i plotë mbi grupet dhe organizatat që vepronin në mbështetje të shoqërisë civile. Më pas, këtyre shoqatave iu kërkua bashkëpunim dhe më pas që të dërgonin përfaqësues të tyre për të marrë pjesë në panel. Por, u shpreh Cami, mbledhjet do të jenë të hapura, dhe nëse shihet se ka një handikap, ose se personat e zgjedhur nuk do ta bëjnë siç duhet detyrën e tyre, sigurisht që kjo do të sjellë ndërrimin e tyre me njerëz më kompetentë.

Ndërsa përfaqësuesja e organizatës "World Vision" në Lezhë, Dorina Ndreca, pyeti lidhur me faktin se ç'pritet që të sjellë ky panel në mbledhjen e radhës. Ishte përfaqësuesja e USAID-it, Blerina Dudushi, e cila u shpreh se në fund të çdo takimi të panelit, vendosen temat për diskutim në takimin e radhës.

"Do të diskutohet për një përballje qytetar – mjek", u shpreh Dudushi, duke vijuar se spitali do ta përdorë panelin për t'u lidhur me qytetarin dhe për të ditur se çfarë ai kërkon, por nga ana tjetër edhe për t'i dhënë qytetarit informacionin e duhur lidhur me vendimet e ndryshme apo rregulla të spitalit.

Nga ana tjetër, në diskutim, drejtoresha e gazetës "Shëndet Plus" sugjeroi edhe përdorimin e portaleve të shkollave të mesme për rritjen e komunikimit me të rinjtë, takime në shkollat e mesme për ndërgjegjësimin e tyre mbi të drejtat e pacientëve etj.

Përfaqësuesja e bashkisë: Paneli do të sjellë zërin qytetar

Yllka Brahimi, punonjëse sociale në Bashkinë e Lezhës, është një nga anëtarët e panelit këshillimor. E pyetur lidhur me funksionin që institucioni ku ajo merr pjesë mund të ketë në panel, Yllka thotë se bashkia është në të vërtetë i pari institucion që përballet me qytetarin dhe që ka lidhje të drejtë me të. Për çdo problem qytetarët i drejtohen bashkisë, sidomos shtresat më të varfëra, të cilat gjithashtu tregojnë edhe problemet e tyre.

Bashkia trajton edhe familjet me ndihmë ekonomike që në Lezhë numërohen rreth 550 dhe me të cilët punonjësit takohen çdo muaj. Punonjësit socialë kanë mundësi intervistimi, si dhe vizitash në shtëpi, duke qe-

në në terren.

Lidhur me idenë e një nisme të tillë, Brahimi thotë se "ta bësh të prekshme mjekësinë është vërtet diçka shumë e mirë, sidomos për shkak të paragjytimeve që ekzistojnë. Ky panel është një vend për të sjellë zërin tonë". Ndër problemet më të shumta që njerëzit kanë raportuar në bashki dhe që lidhen me sistemin shëndetësor e që pritet të diskutohen në panel janë: mosmarrja e shërbimit të duhur; pagesa ekstra, edhe pse nuk janë mundësitë; blerja e ilaçeve në farmaci jashtë spitalit; indiferenca apo paragjykitimi sidomos për pacientët romë apo egjiptianë.

Pritet që ky panel këshillimor të sjellë zgjidhje të problemeve të qytetarëve të Lezhës.





Dr. Ylli Qirinxhi: Projekti, shumë i dobishëm për qytetarët

Nga ana e drejtorisë së spitalit, projekti ka gjetur një mbështetje të madhe dhe një vlerësim të dukshëm, çka reflektohet në punën e bërë në 6 muajt e parë dhe rezultatet e dukshme të arritura deri më tani. Drejtori i spitalit rajonal të Korçës, Ylli Qirinxhi, duke vlerësuar projektin dhe ndikimin e tij pozitiv në shërbimin e ofruar spitalor thekson se puna e nisur do të vazhdojë edhe pas përfundimit të projektit, pasi kjo është në dobi të qytetarëve. Qirinxhiu thotë se gjithsesi ka ende hapa të tjerë për t'u hedhur në zbatim të këtij projekti "pasi çdo gjë

vjen në rritje dhe vlerësimi në zbatimin e projektit në bashkëpunimin që ka drejtorja me USAID-in është që ngritja profesionale, edukimi në vazhdim i personelit, edukimi në vazhdim i qytetarëve, pacientëve, gjë e cila është në programin e përbashkët dhe është në vazhdimësi. Drejtorja është e predispozuar maksimalisht që mbasi të mbarojë programi dhe projekti, këto aktivitete të vazhdojnë, sepse janë pjesë e një vlerësimi edhe nga ana e shërbimit me një higjienë të pastër dhe situatë të vlerësuar për infeksionet spitalore, por edhe nga ana ekonomike, pasi redukton shpenzimet".

Ngritja e "Njësisë së Kontrollit dhe Parandalimit të Infeksioneve Spitalore" pranë Spitalit Rajonal të Korçës në bashkëpunim me USAID-in tashmë ka dhënë rezultate të dukshme, të cilat pritet që hap pas hapi të avancojnë

Infeksionet spitalore në Korçë, bashkëpunim intensiv për uljen e tyre

Eglantina Bardhi

Spitali Rajonal i Korçës falë mbështetjes së USAID-it (Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar) ka përfunduar një prej nismave më të rëndësishme në kuadrin e reformimit të sistemit shëndetësor. Prej 6 muajsh ky spital ka intensifikuar punën e tij për sensibilizimin e personelit spitalor, por edhe qytetarëve në lidhje me parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve spitalore.

Ruajtja e higjienës, zbatimi i një sërë praktikash efektive sa i takon higjienës së duarve dhe sensibilizimi në masë i personelit spitalor, por edhe qytetarëve janë në fokus të këtij projekti që direkt dhe indirekt ul kostot spitalore, por edhe ofron një shërbim të sigurt dhe cilësor.

Ngritja e "Njësisë së Kontrollit dhe Parandalimit të Infeksioneve Spitalore" pranë Spitalit Rajonal të Korçës tashmë ka dhënë edhe rezultate të dukshme, të cilat pritet që hap pas hapi të avancojnë.

Është provuar se larja e duarve redukton morbiditetin dhe mortalitetin e pacientëve nga infeksionet spitalore. Në kohën kur studimet tregojnë se shumica e infeksioneve spitalore shkaktohen si pasojë e mungesës së higjienës së duarve apo mosrespektimit të teknikës së duhur të larjes së duarve, puna nga kjo njësi ka nisur me përgatitjen e posterave ilustrues, të ndihmuar edhe nga projekti "Në mbështetje të reformës në Shëndetësi" dhe të financuar nga USAID-i, postera që janë vendosur në çdo ambient ku ka një lavaman, ndërsa vijon puna për monitorimin e zbatimit të politikës së higjienës së duarve nga personeli. Kjo nismë ka gjetur mbështetje edhe tek drejtorja e spitalit, e cila ka siguruar pajisjen me sapun të lëngshëm dhe dezinfektant, ndërsa po punohet edhe për vendosjen e letrës njëpërdorimshe për tharjen e duarve. Infermierja Anila Sedo, e cila është personeli në njësi të bashku me një mjek infeksioniste tregon punën dhe ecurinë e kësaj nisme.

A janë kontrolluar edhe më përpara infeksionet spitalore?

Infeksionet spitalore janë kontrolluar edhe më herët nga spitali, por ka rreth 6 muaj që është institucionalizuar njësi dhe puna e saj. Ambjente specifike për këtë njësi nuk ka, por është një staf dhe grup pune që monitorojnë ecurinë e nismës dhe zbatimin e saj.

A ka nisma të tjera që po ecin paralelisht në spital? Ka plot nisma të tjera që po ecin paralelisht. Projekti vjen në mbështetje të reformës në shëndetësi dhe mbështetet nga USAID-i. Edhe në kuadër të reformimit të sistemit shëndetësor dhe në veçanti të atij spitalor janë ndërmarrë disa nisma në spi-



Spitali Rajonal, Korçë

Joana Mukelli: Parandalimi, më pak kosto se kurimi

Koordinatorja e projektit, Joana Mukelli, duke folur për disa prej synimeve të projektit ka theksuar sa e rëndësishme është që të vijojë sensibilizimi. Puna e kësaj njësie duhet të vazhdojë edhe pasi projekti të largohet, sepse qëllimi i projektit është vazhdimësia dhe mbështetja e nismave të iniciuara prej tij. Përmes këtij projekti forcohen politikatat, ato bëhen të zbatueshme dhe të qëndrueshme në të ardhmen.

Sipas Mukellit, "posteri mbart një mesazh të fortë vizual edhe në rastin kur dikush mund të harrojë nga nxitimi të lajës duart si duhet, ai shërben si rikujtesë në mënyrë që të evitohet transmetimi i infeksioneve. I rëndësishëm është sensibilizimi, sepse higjiena e duarve është dhe ngelet mënyra më efektive për eliminimin e përhapjes së infeksioneve".

"Kostoja për një infeksion spitalor, - thotë ajo, - është disa herë më e lartë sesa kostoja e sigurimit të disa pajisjeve të thjeshta higjienike (si dezinfektanti apo letra njëpërdorimshe). Siguria është e rëndësishme për personelin edhe për pacientin. Ne apelojmë që kjo nismë pozitive të realizohet nga ministria edhe në spitalet e tjera rajonale në vend".

talit e Korçës. Një prej tyre ka qenë edhe ngritja e njësisë së kontrollit dhe parandalimit të infeksioneve. Për çdo nismë ka një ekip apo grup pune që punon për zbatimin dhe monitorimin e gjithë politikave apo nismave të përbashkëta midis drejtorisë së spitalit dhe projektit. Disa prej tyre janë: menaxhimi i burimeve njerëzore, menaxhimi i kontrollit të vizitorëve, raportimi i incidenteve, nënkontraktimi i shërbimeve joklinike të spitalit, shfrytëzimi i hapësirave spitalore, marrëdhëniet me publikun, kujdesi për klientin etj.

Cili është qëllimi i kësaj njësie?

Kjo njësi ka nisur punën për monitorimin e zbatimit të protokollit të higjienës së duarve nga ana e personelit të spitalit rajonal Korçë. Qëllimi i projektit është përmirësimi i aksesit dhe cilësisë të shërbimit shëndetësor ndaj të varfërve, por jo vetëm.

Në ç'muaj ka nisur puna dhe cilat janë hapat që keni ndjekur?

Njësia e Kontrollit dhe Parandalimit të Infeksioneve Spitalore ka 6 muaj që është krijuar. Fillimisht me ndihmën e USAID-it nisi puna për shpërndarjen e posterave ilustrues për higjienën e duarve. Këta postera u shpërndanë dhe u vendosën në të gjithë lavamanët e spitalit, poliklinikës dhe maternitetit.

Më tej me grupin e punës kemi kryer monitorime të rastësishme në të gjithë pavionet e spitalit, për të parë sesa personeli mjekësor dhe jomjekësor i zbaton hapat. Nga monitorimet e vazhdueshme që janë bërë, në përgjithësi rezultatet kanë qenë të kënaqshme.

Problemi fillestar që kemi hasur ka qenë mbajtja e bizhuterive sidomos nga personeli femëror, por me kalimin e kohës kemi parë sensibilizim. Problemi tjetër ka qenë edhe ai i mbajtjes së thonjve të gjatë, por edhe ky ka shkuar drejt zgjidhjeve.

Pjesë e punës së njësisë është dhe raportimi i gjetjeve të monitorimit. Në fund të çdo muaji përgatitet një raport mujor që pasi diskutohet me grupin e punës, i çohet dhe drejtuesve të spitalit me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse. Nëse ka mangësi ato i vihen në dukje drejtorisë e cila nga ana e saj duhet të marrë masat për t'i korriguar ato.

A ka kërkesa dhe synime të tjera të kësaj nisme?

E vetmja kërkesë që ende nuk është arritur të realizohet, është pajisja me mjete tharëse, çka do të thotë eliminimi i përdorimit të peshqirëve të përbashkët nga stafi mjekësor. Kjo është një çështje për të cilën po lobohet me drejtorinë, por edhe me ministrinë për të pasur fondet e duhura për këtë problem.